



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije - Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Numër: 013-129
Datë: 20.09.2023

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L -113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nenit 11 paragrafit 1.5 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare. nr. 34/18 nëntor 2022), nenit 5 shtojca 1 paragrafi 7 nënparagrafi 7.1 i Rregullores (QRK) nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 15.06.2023, nenit 15 paragrafi 3 i Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 42 paragrafi 4 dhe 8 i Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, Statutit të Qendrës Studentëve në Universitetin e Prishtinës, nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 dhe neni 53 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016.), dhe opinionit ligjor të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP) nr.860 të dt. 01.08.2023 nxjerr:

V E N D I M

Për shfuqizim të Akt emërimit

1. Shfuqizohet Akt emërimi i dt.21.06.2012, i z. Fatmir Sfishta, në pozitën: Drejtor i përgjithshëm i Qendrës së Studentëve.
2. I lartpërmenduri do të sistemohet përshtatshmërisht sipas legjislacionit në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi dhe ka efekt juridik me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Pas analizimit të opinionit ligjor të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP) nr.860 të dt. 01.08.2023, legjislacionit përkatës të Shërbimit Civil dhe Akt emërimit të dt. 21.06.2012, me afat të pakufizuar, janë identifikuar parregullsi dhe shkelje esenciale të

dispozitave ligjore, si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, respektivisht Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, sa i përket emërimit dhe kohëzgjatjes së marrëdhënies së punës, mandatit të z. Fatmir Sfishta, në pozitën: Drejtor i përgjithshëm i Qendrës së Studentëve.

MASHTI, përmes shkresës së dt.08.06.2023 me nr.ref.01B-065, ka kërkuar opinion ligjor nga DMZP në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me Akt emërimit e dt. 21.06.2012 të z. Fatmir Sfishta, i emëruar në pozitën Drejtor i përgjithshëm i Qendrës së Studentëve dhe mandatit të tij.

Në analizën e Statutit të Qendrës së Studentëve në Universitetin e Prishtinës, vërehet se (i) organizimi i Qendrës së Studentëve ka qenë i bazuar në nenin 4, neni 21 dhe 22 të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore, (ii) se QS është institucion me identitet të qartë juridik dhe organizativ në kuptimin e ushtrimit të funksionit publik së (iii) i njëjti institucion, marrëdhënien e punës së stafit të tyre, e ka bazuar në legjislacionin në fuqi, ndër të tjera edhe atë për Shërbimin Civil.

Me datën 01.08.2023 DMZP, ka dhënë opinion ligjor përmes shkresës me nr.860, me të cilin ka konstatuar se Akt emërimi i dt.21.06.2012, i z. Fatmir Sfishta në pozitën e Drejtorit të përgjithshëm të Qendrës së Studentëve në MASHTI është i kundërligjshëm. Gjithashtu, ka konstatuar se është përgjegjësi e MASHTI-t të ndërmerr veprime dhe masa të nevojshme për vendosjen e ligjshmërisë për rastin e pozitës së Drejtorit të përgjithshëm të Qendrës së Studentëve, sepse Ligji nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nuk parashohin që kjo pozitë ta ketë mandatin e përhershëm me kohëzgjatje të pacaktuar.

Akt emërimi i dt. 21.06.2012, i nënshkruar nga Xhavit Dakaj ish-sekretar i përgjithshëm në MASHTI, është i paligjshëm, sepse është në kundërshtim me nenin 15 paragrafi 3 i Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se mandati për pozitën e larta drejtuese është 3 vjeçar. Gjithashtu, është në kundërshtim me nenin 42 paragrafi 4 i Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik pasi që kohëzgjatja dhe mandati i pozitave të larta drejtuese është me kohë të caktuar si dhe me Statutin e Qendrës Studentëve në Universitetin e Prishtinës

Meqë, z. Fatmir Sfishta, në pozitën: Drejtor i përgjithshëm i Qendrës së Studentëve është në këtë pozitë prej vitit 2012 dhe meqë është konsumuar mandati i përcaktuar me legjislacionin në fuqi, shfuqizohet Akt emërimi i dt. 21.06.2012 dhe z. Sfishta lirohet nga pozita e Drejtorit të përgjithshëm të Qendrës së Studentëve, por nëpunësi vazhdon të gëzojë të drejtën e pagës për pozitën e nivelit të lartë drejtues për periudhën 3 mujore.

Andaj, me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë lidhur me emërimin dhe mandatin e Drejtorit të përgjithshëm të Qendrës së Studentëve, në përputhje me dispozitat ligjore të lartpërmendura, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Z. Fatmir Sfishta;
2. Zyrës së SP/MASHTI
3. Kabinetit të Ministres/MASHTI;
4. Qendrës së Studentëve ;
5. Divizionit të BNJ /MASHTI;
6. Arkivit/MASHTI.



Arbërie Nagavci, Ministre

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në Komisionin e ankesave në MASHTI, në afat prej tridhjetë ditësh (30), nga dita e pranimin të vendimit.